

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

NË EMËR TË POPULLIT



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-
divizioni penal, me gjyqtarin individual Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Lavdije
Brahimiqi në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED], nga fshati [REDACTED] e
Komuna [REDACTED], për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 të
KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2320-2/12 të datës
12.06.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës
prokurorit shtetit Avdullah Abedini, të dëmtuarit [REDACTED], nga [REDACTED], rruga
[REDACTED] dhe të akuzuarit me dt.16.08.2017, të njëjtën ditë mori dhe publikisht
komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED], nga fshati [REDACTED] e Ultë, Komuna [REDACTED], i lindur më
[REDACTED] në të njëjtin vend, nga i [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED], ka të kryer
shkollën e mesme, i pa punë, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e
Republikës së Kosovës, me nr. Persona [REDACTED], mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Sepse me datë 31.08.2013, rreth orës 01:00, në Ferizaj, në rrugën “ NaimBeka ”, pas një
mosmarrëveshje të më hershme lidhur me një vajzë, i pandehuri e sulmon të dëmtuarin
[REDACTED] nga [REDACTED], duke e goditur me grushta disa herë në pjesë të dryshme të
trupit, nga të cilat goditje i dëmtuari kishte pësuar lëndime të rënda trupore-prani e ajrit në
hapësirat e lira të anës së majtë të gjokësit, lëndime këto me pasoja të përkohshme për
shëndetin,

-me këtë ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1. të
KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nen. 4,7,17,23,41,42.43,51,52, dhe 73 të KPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurës i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me të cilin e gjykon me dënimbargimi në kohëzgjatje prej 6/gjashtë/ muaj dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimi me burgim të mos ekzekutohet nëse e akuzuara në periudhën kohore prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të merre formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

I dëmtuari [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR], rruga "[REDAKTUAR]", për realizimin kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 € si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Arsy e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2320-2/12 të datës 12.06.2014 e ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 të KPRK-së..

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem pranë aktit akuzues dhe kualifikimit juridik të veprës penale dhe pas administrimit të provave dëgjimit të dëmtuarit [REDAKTUAR], dëshmitarit [REDAKTUAR] dhe provave materiale raporti mjekësor i spitalit të Ferizajit- Qendra Emergjente me numër protokolli 875 tedt. 31.08.2013, fletelëshimi i qendrës klinike QKUK- Prishtine reparti klinik i kirurgjisë torakale Prishtine dt.31.08.2013, ekspertiza mjeko ligjore e dt.02.05.2014 e përpiluar nga eksperti mjekoligjor dr. Naim Uka në emër të dëmtuarit [REDAKTUAR], si dhe nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] të dhene në këtë shqyrtim gjyqësor u vërtetua se i

pandehuri [REDACTED] ka kryer veprën për të cilën akuzohet dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin të shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt.16.08.2017 në të cilin gjyqtari ka ftuar të akuzuarin të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor duke e udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 323 parag.2.1,2.2 dhe 2.3 të KPPK-së.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini përsëri edhe në shqyrtimin kryesor të akuzuarit i ka lexuar aktakuzën dhe pas leximit gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën për të cilën është akuzuar dhe të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë lidhur me veprat penale për të cilën akuzohen.

I akuzuari [REDACTED] nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pasi i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka ftuar prokurorin e shtetit për të përmbledhur provat që mbështesin rastin konform nenit 328 par 1. të KPPK-së.

Komfor nenit 329 gjykata ka bërë prezantimin e provave që i ka konsideruara të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë.

Në shqyrtimin gjyqësor i dëmtuari [REDACTED] në mbrojtjen e tij ka deklaruar se të akuzuarin [REDACTED] nuk e ka njohur asnjëherë por e ka nohur [REDACTED] i cili ka thënë se do ta paguaj dikë për ta rrahur këtë. Me [REDACTED] ka patur problem me të pasi që ky ka shkuar me një vajzë e cila tani është martuar me [REDACTED]. [REDACTED] as që e ka njohur por vetura që e ka ndjekur me [REDACTED] për ta rrahur ku e kanë sulmuar [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED]. Në vazhdim i dëmtuari thekson se e kanë rrahur në oborr para Lokalit në rrugë për fshatin Pleshinë ku kanë ardhur para shtëpisë së tij rreth orës 23:00-24:00, ku i akuzuar [REDACTED] më ka thirrur këtë natë tek AL Petrol ku e kishte ndaluar veturën duk i thënë se veturën nuk e ka diçka në rregull është duke i rrjedhur ulja diku larg 100 nga vendi ku ka ndodhur ngjarja pra ky ka qenë kryesori që e ka sulmuar me [REDACTED] dhe [REDACTED]. Pas rrahjes ka shkuar në Emergjencë nga rrahja ju është ndaluar frymarrja ku i'u

është bërë edhe inqizimi ku kam arritur policia të cilët i kam thirrur spitali, të njëjtit më kanë thënë kush të ka sulmuar por nuk kam mundur për shkak të gjendjes së keqe shëndetësore më pas më kanë dërguar në Prishtinë me Emergjencë, pas lirimit nga spitali në Prishtinë përsëri në shtëpi kam ardhur policia dhe pas dy jave diku kam dhënë deklaratë për ngjarjen. Edhe njeherë e njoftoj gjyqtarin dhe prokurorin se të pandehurin nuk e kam njohur asnjëherë as si person as si figurë, vendi ku më kanë sulmuar ka pasur ndriqim të dobët personat e AL Petrolit më kanë thënë se policist mund të jap video ty jo, se aty shihet Jetoni duke pritur. Ai ka qenë i veshur me të zeza me duket se nuk më kujtohet. I njëjti më ka sulmuar me grushta dhe aty kam ardhur me mercedes të zi [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Kontaktin e parë e kam pasur me [REDAKTUAR] dhe nën përcjelljen e dy të tjerëve pra [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], ata kanë ardhur pas pesë minutave dhe më kanë sulmuar edhe ata, unë nuk e kam goditur dhe nuk kam pasur asgjë në dorë. Lokali afër shtëpisë ka qenë i imi dhe tani nuk është, afër ti ka qenë një lokal i prishur dhe aty e kam lënë kerrin atë kohë. Me jetonin nuk kam pasur asnjëherë kontakt ndërsa me [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kam pasur kontakt edhe më tutje.

Dëshmitari [REDAKTUAR] ka deklaruar se ai natën kritike ka dalur të ble cigare afër marketit Vullneti që gjendet në udhëkryqin e rrugës "Naim Beka" dhe "Epopeja e Jezercit" e ka verjetur një person me një dru në dorë, i cili ju ka ofruar afër veturës Golf IV" e cila më pas është ndalur, është ndalur shoferi i kësaj veture dhe ka dalur shoferi dhe i aka hjekur drurin nga dora, ai ka deklaruar se ka qenë me larg dhe vetëm e kam parë se e ka goditur me grushta dhe personi i cili ishte në rrugë me dru dhe më pas është larguar nga aty.

Të akuzuarit [REDAKTUAR], konform nenit 325 të KPPK-së në shqyrtimin gjyqësor i është dhënë mundësia për të deklaruar lidhur me fajësinë, ku e njëjti ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilat ngarkohet. I akuzuari në mbrojtjen e tij ka deklaruar se : mbetem pranë deklaratës së dhënë në polici. Po natën kritike më dt.31.08.2013 rreth orës 01:00 në Ferizaj konkretisht tek rruga " Naim Beka dhe rruga Epopeja e Jezercit ka kaluar me veturën e tij Golf IV. Natën për të cilën akuzohet në vendin e lartë cekur iu kujtohet se iu është ofruar me një dru në dorë [REDAKTUAR] i cili ka bërë titull dil jashtë , ky e ka dëgjuar dhe është ndalur menjëherë dhe ka zbritur nga vetura ku [REDAKTUAR] iu është vërsulur dhe më e ka sulmuar dy here në anën e majte me dru. Pasi e ka goditur I njëjti ja kam kapur shkopin dhe e ka goditur me dorën tjetër dy-tri here me grusht. Nuk iu kujtohet ku e ka goditur mirpo sa iu kujtohet e ka goditur në koke dhe në trup dikun. Goditjen deklaroi se e ka bërë me qëllim që të ja marr shkopin. Pasi që ja ka kapur shkopin duke u kacafytur

janë rrezuar te dy. Pasi qe e ka goditur ne fund ka arritur te ja marr shkopin me pas i njëjti eshte larguar gjithashtu edhe I pandehuri e ka marrur shkopin e ka futur ne veture dhe eshtë larguar. Nga ngjarja qe ka ndodhur nuk janë pajtuar mirpo as nuk kanë raporte te acaruar.

Gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8 dhe nenin 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së vlerësoi provat një nga një dhe të gjitha së bashku si dhe lidhje me provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale dhe në bazë të vlersimit të tillë është provuar se i akuzuari [REDAKTUAR] me datë 31.08.2013, rreth orës 01:00, në Ferizaj, në rrugën “ Naim Beka ”, pas një mosmarrëveshje të më hershme lidhur me një vajzë, i pandehuri e sulmon të dëmtuarin [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], duke e goditur me grushta disa herë në pjesë të ndryshme të trupit,nga të cilat goditje i dëmtuari kishte pësuar lëndime të rënda trupore-prani e ajrit në hapësirat e lira të anës së majtë të gjokësit, lëndime këto me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmia e të dëmtuarit [REDAKTUAR], dëshmitarit [REDAKTUAR] guri e pjesërisht edhe nga mbrojtia e dhënë e të akuzuarit i cili ka pranuar se ka patur një problem me të dëmtuarin [REDAKTUAR] para dy muajëve ku sa herë që e ka takuar këtë e ka kqyrë shtremtë dhe heren tjetër është ndalur për ta pytur pse po e shiqon ashtu por [REDAKTUAR] i ka thënë prit se është duke folur e telefon dhe me vetur për momentin është largua nga aty por më von është kthyer përsër që ta pyet dhe [REDAKTUAR] i ka bër me dorë që të ndalet dhe posa është ndalur e shef se te dera e shtëpis së tij e merrë një shko druri dhe është drejtuar nga ky ku ishte ndalur veturen dhe pa pritje e ka goditur e ka goditur dy herë në krah, e në vetëmbrojtje të dëmtuarin e ka goditur një herë në fytyrë, njëher në kokë dhe njëher në trup dhe [REDAKTUAR] është larguar nga aty e pastaj edhe ky është larguar dhe i dëmtuar pmenjëher është shkaur në Qendren Emergjente në Ferizaj-Spitali Regjional i Ferizajit, ku nga aty është dërguar në Qendren Klinike Univerzitare të Kosovës në Repartin e Kirurgjisë torakale për shkak të lëndimeve që ka pësuar nga rrahja.

Gjykata dëshmitë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] ka vlerësuar si të besueshme, objektive dhe reale, pasi që e njëjta në mënyrë kronologjike dhe të saktë e ka përshkuar rrjedhën e ngjarjes, intervistuar në zyren e Sektorit Rajonal të Hetimeve në Ferizaj me datën 17.10.2013 dhe në shqyrtimi gjyqësor të datës 14.06.2017. se është rrahur nga i akuzuari [REDAKTUAR] dhe nga lëndimet që ka pësuar ka shkuar në Emergjencë ku ka patur problem me frymarrje ku i'u është bërë edhe një inqizim dhe në spital kan arritur edhe policia për ta pytur se nga kushë është rrahur për shkak të gjendjes shëndetësore nui ka mundur t'u

përgjigjet dhe menjëher është dërguar në Prishtinë në spital dhe pas dy jave kur është kthyer në shtëpi i kanë ardhur policia dhe atëher ka dhënë deklaratën lidhur me ngjarjen në tërësi e për lëndmet që ka pësuar është edhe mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor dr.Naim Ukai datës 17.04.2014 si dhe Fletëlëshimi i raporti i Qendren Klinike Univerzitare të Kosovës në Repartin e Kirurgjisë torakale i datës 31.08.2013 dhe shkresat tjera të lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarës [REDAKTUAR] manifestohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1. të KPRK-së, të kryer në kohën, në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 të KPRK-së ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjkata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysh faktin se nuk ka të dhëna se e akuzuari më parë është gjykuar për ndonjë veprë penale, pendohet për veprën e kryer, ftesave te gjykatës gjithherë i është përgjigjur me kohe, ka pasur sjellje korrekte, prej kohës se kryerjes se kësaj veprë penale me te dëmtuarin nuk ka pasur asgjë te keqe, mbajtës i familjes, e në mungesë të rrethanave rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale duke i shqiptuar dënim të kushtëzuar si në dispozitiv të aktgjykimit me bindjen se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale me bindje se me këtë lloj të dënimit, do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

I dëmtuari [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR], rruga "[REDAKTUAR]", për realizimii kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil..

Obligohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për ekspertizën mjeko ligjore të paguaj shumën prej 20 € si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.


Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

P. nr. 692/14, dt. 16.08.2017


Zyrtaria Ligjore

Lavdije Brahhimi



Gjyqtari,

Adem Shabani



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në

afat prej 15 ditëve nga dita e pranimet të tij,

Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.